

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
AI MAISON

NENI 1
FORMIMI

Sot me date **02.10.2024** themeluesi qe firmos me poshte:

1. **Z.Albin Istogu**, shtetas Kosovar, atesia Shaip, i datëlindjes 04.02.1987 lindur në Kosove, banues në Kosove madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.Personal: ID 0423987.

Ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 „Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare „ si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit “ themeloj me vullnet te lire shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar ,me emertim **AI MAISON**.

NENI 2
SELIA

Selia e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **AI MAISON**, me adrese Tirane, Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Brigada VIII, Pallati Nr.19, Kati 3,Ap. 4. Shoqeria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **AI MAISON** eshte pa afat nga momenti i regjistrimit te saj prane QKB Tirane.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise **AI MAISON** eshte:

- Blerja, zhvillimi, shitja dhe dhenia me qera e pasurive te paluajtshme; Investime ne fushën e ndërtimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit te pasurive te paluajtshme. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Dhenie me qira, nen qira te ambjenteve te ndryshme. Organizimi i eventeve, publikime, reklama dhe fushata reklamuese, si dhe organizim tjetër perfshire promovimi i pasurive te paluajtshme.
- Aktivitet ne fushen e projektimit konsulence ne restaurim, projektim arkitektonik, projekt interior, dezajn, projekte per ndertim dhe infrastrukture, sherbim ne krijimin e infrastrukture elektrike, hidraulike, Hvac per godina ose objekte civile. Studime urbanistike te te gjitha niveleve, planifikim urban. Studim projektim arkitektonik per te gjita llojet e objekteve te ndertimeve civile, industriale, sportive, social-kulturore, agro-perpunuese, turistike, peizashe, interiere, portuale, aeroportuale, heliporte.
- Tregetim i lendes drusore, materialeve te ngjashme me to me shumice dhe pakice, Import – Export dhe shitje brenda vendit e drurit te perpunuar dhe/ose stazhionuar, skandinav apo llojeve dhe cilesive te ndryshme sipas % se lageshitse, densitetit, elasticitetit dhe rezistences ndaj zjarrit duke perfshire CLT, trare, fiber, dru i presuar etj pa u kufizuar vetem ne to, me qellim montim, asamblim dhe/ose prodhimin e shtepive me sturkture druri.

Shoqeria mund te kryeje edhe aktivite te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë **AI MAISON** është **100,000 leke** dhe i ndare ne 1 kuote me kontributin e ortakut te vetem te shoqerise, si meposhtë:

1. Një kuote **Z. Albin Istogu** masën 100 % (njqind perqind) te kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku themelues , ai mund të ndryshoje sipas vendimit që mund të marri ortaku, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 6

ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese te shoqërisë **AI MAISON** janë:

- Asambleja e Ortakeve ,organi me i larte vendim marres
- Administratori shoqerise do te jete : **Z. Albin Istogu** me nr personal ID 0423987
- Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet, nga data **02/10/2024 deri ne 02/10/2029**.

NENI 7

Organizimi i shoqerise ,marredheniet me persona fizik e juridike ,vendas apo te huaj ,shprehen ne status qe bashke me aktin themelimit jane dokumentat baze te veprimtarise dhe sherbejne per zhvillimin e marredhenieve ne kete shoqeri

NENI 8

Veprimtarine e saj ,shoqeria do te zhvilloje ne perputhje me legjislacioni Shqiptar.

NENI 9

Te gjitha mosmarreveshjet me persona fizike ose juridik si dhe me organet shteterore zgjidhen me mirekuptim , me ane te dispozitave te ketij akti ,statuti si dhe legjislacioni shqiptar dhe kur keto mjete nuk japin rezultat atehere zgjidhen me gjykate

Ky akt themelimi hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **AI MAISON** ne QKB ne kete dite shoqeria **AI MAISON** njihet si person juridik

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE “AI MAISON“

Z. Albin Istogu

Albin Istogu

D.I.